



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:192924
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728857

P.nr.2023:192924

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Samedin Cena, me bashkëpunëtorin profesional Sefedin Avdijaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit K.G., nga Gjakova për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2, nën par.2.1 lidhur me par.1 nën par.1.2 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm sipas Aktakuzës me numër PP/II.nr.1297/2023 të datës 29.09.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 20.05.2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit Shqiponja Jupa, palës së dëmtuar L.K., dhe të akuzuarit K.G. me mbrojtësen e tij Avokate Edona Sina nga Gjakova me datë 22.05.2024, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari

K.G., i lindur me datë ... në Gjakovë, ku edhe tani banon Rr. "...", nr . . . , nga i ati ..dhe e ëma ... e vajzërisë ..., i pa martuar, i punësuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 29.08.2023, rreth orës 11:09 min, në Rr. "...” në Gjakovë, i pandehuri merr pasurinë e personit tjetër, këtu të dëmtuarit L.k., nga Gjakova, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete duke depërtuar me forcë në ndërtesat e mbyllura ose duke hequr pengesat e tjera, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri hyn në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit, me forcë ngrit roletat e dritares, e po ashtu forcërisht e hap dritaren dhe futet brenda në shtëpi nga ku merr para në vlerë prej 4300 euro, një orë Smart Apple Watch në vlerë prej 470 euro, një orë Ferruci në vlerë rreth 100 euro si dhe një unazë ari në vlerë rreth 350 euro, të cilat

i merr dhe largohet në drejtim të panjohur, me çka të dëmtuarit i shkakton dëm material në vlerë rreth 5220 euro.

- Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2 nën par.2.1 lidhur me par.1 nën par.1.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,7,17,38,39,40,46,48,49, 69,70, 71 të KPRK-së dhe neneve 242, 358, 364 e 365 të KPPRK-së, i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i përcaktohet:

- I. Dënimi me burg në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej dy (2) vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. Gjykata mund ta revokon dënimin me kusht me burgim nëse i dënuari gjatë kohës së verifikimit në kohëzgjatje prej dy (2) vitesh duke filluar nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë kryen një apo më shumë vepra penale.
- III. Në bazë të nenit 79 të KPRK-së të akuzuarit K.G. koha e kaluar në paraburgim nga data 10.09.2023 deri me datë 10.10.2023, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar në rast të revokimit të këtij dënimi.
- IV. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë Euro) si dhe në bazë të nenit 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 € (njëzet Euro), në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V. I dëmtuari L.K. nga Gjakova, për realizimin e kërkesës pasurore udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë –Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate, ka parashtruar Aktakuzën me numër PP.II.nr.1297/2023 të datës 29.09.2023, kundër të akuzuarit K.G. nga Gjakova, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2 nën par.2.1 lidhur me par.1 nën par.1.2 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata për këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin fillestar me datën 20.05.2024, ku në seancë ka marrë pjesë Prokurorja e Shtetit Shqiptonja Jupa, i dëmtuari L.K., dhe i akuzuari K.G., me mbrojtësen e tij avokate Edona Sina nga Gjakova.

I akuzuari K.G., pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shteti deklaroi se pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për favorët dhe pasojat e pranimi të fajësisë, lidhur me fajësinë deklaroi se e pranoi fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, i kërkoj falje palës së dëmtuar, kam qenë nën ndikim të narkotikëve, me palën i kemi rregulluar marrëdhëniet.

E autorizuar e të akuzuarit avokate Edona Sina lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin tim dhe sqarimit të nevojshëm për favorët dhe pasojat e pranimi të fajit dhe kualifikimit ligjor të përshkruar si në aktakuzë i propozoj gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajit.

Prokurori i Shtetit Shqiptonja Jupa lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë të bërë nga ana këtu e të pandehurit K.G., se ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion duke i ditur pasojat dhe benefitet e pranimi të fajësisë, një pranim i tillë i cili është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij Avokate Edona Sina, po ashtu faktin se ky pranim i fajësisë gjen mbështetje në provat materiale edhe personale në baze të të cilave është paraqitur gjendja faktike si në dispozitivin e aktakuzës ku edhe përmbushen elementet e veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315, par. 2, nënpar. 2.1 lidhur me par.1, nënpar. 1.2 të KPRK-së. Lidhur me vendimin për caktimin e dënimit i propozoj gjykatës që si rrethanë lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë si dhe bashkëpunimi me organet e drejtësisë kjo konform nenit 70, par. 3, pika 3.10 të KPRK-së ndërsa si rrethanë rënduese të merret parasysh shkalla e lartë e dashjes për kryerjen e kësaj veprë penale si dhe rrezikshmëria e veprës penale po ashtu njëherit i propozoj gjykatës që të pandehurin ta obligon në pagesën e shpenzimeve procedurale.

I dëmtuari L.K., lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, nuk i bashkangjitem ndjekjes penale dhe kërkoj kompensim dëmi.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata në shqyrtim fillestar pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilën ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari K.G. nga Gjakova, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2 nën par.2.1 lidhur me par.1 nën par.1.2 të KPRK-së, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së.

Gjatë pranimit të fajësisë gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale, që i vihet në barrë, dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana Gjykatës për pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë si dhe duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë gjykata ka konsideruar se nuk do të ketë procedurë të provave e as fjalë përfundimtare.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike se:

I akuzuari K.G., nga Gjakova, ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2 nën par.2.1 lidhur me par.1 nën par.1.2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ashtu që me datë 29.08.2023, rreth orës 11:09 min, në Rr. “...” në Gjakovë, i pandehuri merr pasurinë e personit tjetër, këtu të dëmtuarit L.K. nga Gjakova, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete duke depërtuar me forcë në ndërtesat e mbyllura ose duke hequr pengesat e tjera, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri hyn në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit, me forcë ngrit roletat e dritares, e po ashtu forcërisht e hap dritaren dhe futet brenda në shtëpi nga ku merr para në vlerë prej 4300 euro, një orë Smart Apple Watch në vlerë prej 470 Euro, një orë Ferruci në vlerë rreth 100 euro si dhe një unazë ari në vlerë rreth 350 euro, të cilat i merr dhe largohet në drejtim të panjohur, me çka të dëmtuarit i shkakton dëm material në vlerë rreth 5220 Euro.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi edhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë: Raporti i oficerit F.B., me nr.2023-EA-1258 i datës 31.08.2023; Deklarata e të dëmtuarit L.K., dhënë në Stacionin Policor në Gjakovë me datë 01.09.2023; Deklarata e të pandehurit K.G. dhënë në Stacionin Policor në Gjakovë me datë 10.09.2023; Deklarata e dëshmitarit B.I. dhënë në Stacionin Policor në Gjakovë me datë 10.09.2023; Procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm i datës 10.09.2023 me nr.2023-EA-1258; Deklarata e të dëmtuarit L.K., dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me datë 20.09.2023, Deklarata e të pandehurit K.G. dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë ne datë 25.09.2023; CD-Video incizimi i dt.29.08.2023 me nr.2023-EA-1258; Foto dokumentacioni, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 315 paragrafi 1, nën par. 1.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Vjedhja e rëndë kryen “Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 313 të këtij Kodi, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet, nëse vepra është kryer duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sanduqet apo hapësirat tjera të mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme”.

Në paragrafin 2, nënpar.2.1 të këtij neni parashihet se: “Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 313 ose neni 314 të këtij Kodi ose paragrafi 1. i këtij neni dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet, nëse pasuria apo shërbimi i vjedhur ka vlerë mbi pesëmijë (5.000) Euro”.

5. Vendimi

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, si dhe me vetë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin K.G., nga Gjakova, e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2 nën par.2.1 lidhur me par.1 nën par.1.2 të KPRK-së, e bazuar në këtë ka vendosur që të akuzuarin të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parapara nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikonin në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: gjendja e dobët ekonomike, i vetëdijshëm për rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo vepër penale, është penduar thellë për veprën penale të kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do ta përsëritë këtë vepër penale. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë, shprehjen e keqardhjes për veprën që e ka kryer dhe faktin se ma palën e dëmtuar i kanë rregulluar marrëdhëniet.

Ndërsa si rrethanë rënduese gjatë nxjerrjes së këtij vendimi gjykata mori parasysh peshën e veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit shoqëror që paraqesin këto vepra penale.

Gjykata duke marrë parasysh të lartëcekurat duke mbështetur në nenin 71, par.1, nënpar.1.2 ka ardhur në përfundim se në rastin konkret janë përmbushur kushtet ligjore për shqiptimin e dënimit nën minimumin e paraparë, andaj me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i

shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Llogaritja e masës së paraburgimit në dënimin e shqiptuar

Me nenin 79 të KPRK-së është paraparë se: *“Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënimin me gjobë”*, andaj gjykata në këtë rast të akuzuarit K.G. koha e kaluar në paraburgim sipas Aktvendimit PPr.nr.2023:192924 të datës 11.09.2023 dhe atë nga data 10.09.2023 deri me datë 10.10.2023, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar në rast të revokimit të këtij dënimi.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

9. Kërkesa pasurore juridike

I dëmtuari L.K., nga Gjakova, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Mbrojtësja e të akuzuarit Avokte Edona Sina i ka dorëzuar gjykatës një marrëveshje për kompensim të dëmit të nënshkruar nga i akuzuari K.G.dhe i dëmtuari L.K., mirëpo nga përmbajtja e të njëjtës gjykata nuk ka mundur të përcaktojë lartësinë e dëmit dhe shumën e kompensuar, andaj gjykata lidhur me kërkesën pasurore juridike nuk mund të vendos në bazë të kësaj prove, pasi që nuk ka mundur të vërtetojë lartësinë e dëmit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 par.2 të KPPK-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë andaj gjykata nuk mund të merr vendim lidhur me këtë çështje.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

Numri i lëndës: 2023:192924
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728857

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.2023:192924, më datë 22.05.2024

Bashkëpunëtori profesional
Sefedin Avdijaj

Gjyqtari
Samedin Cena

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.